



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndertesa e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: [fn@uni-pr.edu](mailto:fn@uni-pr.edu)

Ref. nr. 4043/1 Prishtinë 17.11. 2022

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

DEPARTAMENTI KONSTRUKTIV

Studenti **Hanumshahe Selishta** ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: " **Projekti kryesorë i konstruksionit të objektit sallë rekreative sportive B+P+2K në Lagjen Kalabri Prishtinë** " në programin e studimeve Master Konstruktiv dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

ABSTRAKT

Qëllimi i këtij punimi është prezantimi i llogarisë strukturore të një objekti me destinim: "Sallë rekreative sportive B+P+2K. Projekti kryesor për fazën konstruktive të objektit është punuar duke u bazuar në projektin arkitektonik, i cili ka formë të rregullt në bazë. Struktura e objektit në fjalë është i projektuar nga betoni i armuar me sistem të tipit skeletor me rama, ndërsa pjesa e mbulesës është nga çeliku sistem kapriatë hapësinore lineare e mbështetur në shtyllat e betonit të kryqëzuara në mes veti ku të gjitha ndikimet si ato horizontale dhe vertikale pranohen nga këto elemente (shtyllat), prej nga përcillen në fundament. Trajtimi dhe dimensionimi i të gjitha elementeve si ato horizontale dhe vertikale janë bërë duke u mbështetur në normat Europiane për projektim EUROCODE të cilat janë paraqitur në kapitullin e 3.

Në kapitullin e 1 janë paraqitur njohuri të përgjithshme për palestrat sportive, rregullat e projektimit dhe specifikimet e nevojshme që duhet të merren parasysh gjatë projektimit të një palestre sportive.

Në kapitullin e 2 është paraqitur Arkitektura e Sallës Rekreative Sportive dhe përshkrimi teknik, prerejt dhe bazat e nevojshme.

Në kapitullin e 3 është paraqitur projekti kryesor i konstruksionit Sallë Rekreative Sportive B+P+2K. Struktura e konstruksionit është përvetësuar si sistem ramë, sistem dual, sistem me mure të çiftuar me duktilitet mesatar (DCM), ku në këtë pikë janë trajtuar:

3.1 Raporti teknik - ku kemi bazat për analizë dhe projektim të struktures, rregulloret, materialet, koeficientët e sigurisë, ngarkesat, mbrojtja në punë, punët përgatitore, aplikimi i rregullave për mbrojtje nga zjarri, punët e gërmimit dhe mbushjes, elaborati gjeomekanik, identifikimi i zones sizmike dhe tipit të truallit, qëndrueshmëria (durabiliteti) e struktures, veprimi sizmik, përmasat e elementeve të struktures etj.

3.2. Analiza e ngarkesave – shqyrtimi i ngarkesave të përhershme dhe përkohshme si dhe analiza e ngarkesës nga era dhe bora.

3.3. Modelimi i strukturës – është paraqitur analiza strukturore për përcaktimi i peshave sizmike, perioda e lëkundjeve, përdredhja aksidentale, kombinimi i efekteve të komponenteve të veprimit sizmik.

3.4. Konstruksioni i kulmit – ku është bërë dimensionimi i shufrave si dhe shqyrtimi i nyjeve të përzgjedhura.

3.5. Verifikimet në gjendjen e fundit kufitare dhe verifikimet gjeometrike- për shqyrtim është marrë trau dhe shtyllat e një nyje, është bërë detajimi për duktilitet lokal, si dhe dimensionimi i pllakës së përdhësës dhe kontrolli i gjendjes së plasaritje dhe uljeve për këtë pllakë, poashtu është bërë dimensionimi i pllakës së themelit dhe mosdepërtimi i shtyllës në themel.

Për llogaritjen dhe detajet e armimit të këtyre elementeve janë përdorur parimet e projektimit sipas kapaciteteve, ku verifikimi strukturor i elementeve ndjek kërkesat e pjesës 1 të Eurokodit 8, dhe gjithashtu ato të pjesës 1-1 të Eurokodit 2.

Në kapitullin e 4 është paraqit aneks dokumenti i këtij punimi ku janë bashkangjitur edhe vizatimet me detale të armimit për elementet e shqyrtuara.

Në kapitullin e 5 dhe 6 janë paraqitur përfundimet dhe literatura.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.